



PSH.nr.1079/20
1090/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Milaim Bejta B.I Bushgegu89”-Prishtinë dhe OE N.T.P “AGONITI”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “AMOE” shpk -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK VUSHTRRI”, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara ankesa e operatorëve ekonomik “Milaim Bejta B.I Bushgegu89”-Prishtinë dhe OE “N.T.P “AGONITI”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK VUSHTRRI”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK VUSHTRRI”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik “Milaim Bejta B.I Bushgegu89”-Prishtinë dhe OE N.T.P “AGONITI”-Prishtinë, aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Milaim Bejta B.I Bushgegu89”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 10.12.2020 me nr. 1079/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK VUSHTRRI”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet; 1, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues N.T.P “AGONITI”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 14.12.2020 me nr. 1090/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje” me nr. të prokurimit: 644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK VUSHTRRI”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “AGONITI”

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.1079/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes. Sqarojmë se OSHP përmes vendimit të fundit për këtë qështje, vendimi nr.809/2020 me datë 13.11.2020 ka konstatuar se OE :”AOME” i mbulon kërkesat për projekte të realizuara (AK ka përcaktuar variant “njëjta” dhe “ngjashme”).

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë se AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë, OE pretendon se herën e parë kur i janë kërkuar sqarime punëtori i OE i ka pasur prindërit me COVID-19 dhe i njëjti ka qenë i obliguar të rri në izolim.

Me gjithë këtë OE pretendon se AK është dashur ti kërkoj prap sqarim shtesë me rastin e rivlerësimit.

Eksperti shqyrtues duke pas parasysh se OE tani i rekomanduar për kontratë, me vendim të OSHP-së është konstatuar se i plotëson kërkesat e dosjes që kontestohen nga OE tjerë, e po ashtu i njëjti është me çmimin më të ulët nga gjithë OE-të pjesëmarrës, vlerëson se kthimi i lëndës në rivlerësim për sqarime shtesë nuk do të sillte ndryshim në rezultat final të këtij aktiviteti të prokurimit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Milaim Bejta B.I BUSHGEGU89”

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.1090/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes.

Sqarojmë se OSHP përmes vendimit të fundit për këtë qështje, vendimi nr.809/2020 me datë 13.11.2020 ka konstatuar se OE :”AOME” i mbulon kërkesat për projekte të realizuara (AK ka përcaktuar variant “njëjta” dhe “ngjashme”).

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë sipas ankesës 1090/20 është se vërtetimi i APK për OE të rekomanduar për kontratë “mund” të jetë i falsifikuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk kemi autoritet, e as kapacitet teknik/professional për tu përgjigjur në një pretendim të tillë ankimorë. Mendojmë që OE ankues për pretendime të tilla do duhej drejtuar organeve

kompetente. Në të njëjtën kohë OSHP përmes vendimit nr.809/20 ka vlerësuar se: *“inicimi i një procedure ndaj një operatori ekonomik të caktuar nuk e penalizon apo përjashton nga pjesëmarrja në një aktivitet të prokurimit apo të kontraktos një punë të caktuar, përkatësisht nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 65 të LPP-së për përjashtim nga procedura e prokurimit apo eliminim të operatorit ekonomik”*.

Ndërsa sa i përket qështjes se pronari i OE ankues (më herët i rekomanduar për kontratë) është i dënuar për veprë penale, sqarojmë se edhe kjo qështje është trajtuar përmes vendimit të OSHP-së nr.809/20 të datës 13.11.2020, me të cilin rast OSHP ka konstatuar se rekomandimi për kontratë ishte bërë në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së. Bazuar në këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të refuzohen si të pabazuara, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 25.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimi e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik “Milaim Bejta B.I Bushgegu89”-Prishtinë, me datë: 18.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me raportin ekspertit shqyrtues të OSHP-së të dt: 22.12.2020 ne si operator ekonomik ankues deklarojmë dr nuk pajtohemi fare me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Siq shihet nga përmbajtja e raportit prej vetëm dy konstatimeve eksperti shqyrtues pothuajse fare nuk i ka trajtuar pretendimet tona ankimore, por vetëm iu ka referuar vendimit të fundit të panelit shqyrtues PSH.809/20 të dt:13.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje”, me nr të prok:Vu 644-20-21-1-1-1. I shpallur nga AK –Komuna e Vushtrrisë .

Pra eskeptri shqyrtues ne rastin konkret nuk ka zbatuar detyren e tij conform nenit 113 dhe 114 të LPP-së sepse nuk i ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore siq parashihet në nenet e apostrofuara. Në ankesën tonë kemi ofruar një mori argumentesh me të cilat provojmë se OE “ AMOE” është i papërgjegjshëm si operator ekonomik, por fatkeqësisht këto argumente dhe prova tona nuk janë trajtuar nga ana e ekspertit shqyrtues .

Për të mos përsëritur edhe në këtë përgjigje deklarojmë se nuk pajtohemi fare me raportin e ekspertit shqyrtues dhe deklarojmë se edhe me tutje mbetemi pranë ankësë dhe pretendimeve tona ankimore. Kerkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së të mbaje seance degjimore dhe të na ftojë edhe në mënyrë qelimit të prezantimit të fakteve dhe provave tona pranë panelit shqyrtues.

Operatori Ekonomik OE: N.T.P "AGONITI"-Prishtinë me datë: 22.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues,
PER : ORGANIN SHQYRTUES TE PROKURIMIT PUBLIK TE KOSOVES
NGA : N.T.P."AGONITI" PRISHTINE
LENDA : PERGJEGJE NE RAPORTIN E EKSPERTIT

Përkitazi me raportin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së të dt.22.12.2020 ne si operator ekonomik ankues deklarojmë se nuk pajtohemi me konstatimet e ekspertit shqyrtues .Gjatë shiqimit të raportit fare qartë vërehet se eksperti shqyrtues nuk I ka shtjelluar pretendimet tona ankimore.I njejt ekspert vetëm me dy konstatime në raport e arsyeton raportin e tij pa shtjelluar pretendimet tona ankimore.Eksperti në përgjegjen nr.2 të raportit të ekspertizës thekson se kthimi i lëndës në rivlerësim nuk do të ndikonte në rezultatin përfundimtar -pa u deklaruar se a është e bazuar ankesa jonë.Ai tutje përsërit se OE"AOOME" është operator ekonomik I përgjegjshëm duke përmendur "Variantin" pa bazë ligjore , sepse nuk lejohet në asnjë dosje të tenderit që njëkohësisht të kërkohen referenca të njejt apo të ngjashme , por mund të kërkohen referena të natyrës së njejtë apo të ngjashme e jo të dyjave njëkohësisht në të njejtën dosje të tenderit. Gjithashtu eksperti nuk ka shqyrtuar pikat tona ankimore siq ka obligim ligjor conform dispozitave të LPP-së.Ne edhe më tutje qëndrojmë pranë ankesës tonë dhe kërkojmë nga paneli shqyrtues që ankesën tonë ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me dru për ngrohje", me nr.prok: VU 644-20-21-20-1-1-1.i shpallur nga AK-Komuna e Vushtrrisë ta krhejë në rivlerësim.Gjithashtu propozojmë që të mbahet séance dëgjimore me pale-ku do të ftohemi edhe ne me qëllim të demonstrimit të provave tona.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pretendimi kryesor ankimor i OE ankues "AGONITI" sipas ankesës nr.1079/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se përmes vendimit të fundit për këtë çështje me numër PSH.nr.809/2020 i datës 13.11.2020 është konstatuar se OE "AOOME" i mbulon

kërkesat për projekte të realizuara (AK ka përcaktuar variant “njëjta” dhe “ngjashme”). Bazuar në këto që u cekën më lart, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “AGONITI” se AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë, OE pretendon se herën e parë kur i janë kërkuar sqarime punëtori i OE i ka pasur prindërit me COVID-19 dhe i njëjti ka qenë i obliguar të rri në izolim. Me gjithë këtë OE pretendon se AK është dashur ti kërkoj përsëri sqarim shtesë me rastin e rivlerësimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pas parasysh se OE tani i rekomanduar për kontratë, me vendim të OSHP-së është konstatuar se i plotëson kërkesat e dosjes që kontestohen nga OE tjerë, e po ashtu i njëjti është me çmimin më të ulët nga gjithë OE-të pjesëmarrës, atëherë kthimi i lëndës në rivlerësim për sqarime shtesë nuk do të sillte ndryshim në rezultatin final të këtij aktiviteti të prokurimit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Milaim Bejta B.I BUSHGEGU89”

Pretendimi kryesor ankimor i OE ankues “Milaim Bejta B.I. BUSHGEGU89” sipas ankesës nr.1090/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se përmes vendimit të fundit për këtë çështje me numër PSH.nr.809/2020 i datës 13.11.2020 është konstatuar se OE “AOME” i mbulon kërkesat për projekte të realizuara (AK ka përcaktuar variant “njëjta” dhe “ngjashme”). Bazuar në këto që u cekën më lart, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi i dytë ankimor sipas ankesës 1090/20 është se vërtetimi i APK për OE të rekomanduar për kontratë “mund” të jetë i falsifikuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nuk kemi autoritet, e as kapacitet teknik/professional për tu përgjigjur në një pretendim të tillë ankimor. Mendojmë që OE ankues për pretendime të tilla do duhej drejtuar organeve kompetente. Në të njëjtën kohë OSHP përmes vendimit nr.809/20 ka vlerësuar se: *“inicimi i një procedure ndaj një operatori ekonomik të caktuar nuk e penalizon apo përjashton nga pjesëmarrja në një aktivitet të prokurimit apo të kontraktos një punë të caktuar, përkatësisht nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 65 të LPP-së për përjashtim nga procedura e prokurimit apo eliminim të operatorit ekonomik”*.

Ndërsa sa i përket çështjes se pronari i OE ankues (më herët i rekomanduar për kontratë) është i dënuar për vepër penale, sqarojmë se edhe kjo çështje është trajtuar përmes vendimit të OSHP-së nr.809/20 të datës

13.11.2020, me të cilin rast OSHP ka konstatuar se rekomandimi për kontratë ishte bërë në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së. Bazuar në këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë vlerësim të drejt të tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në bazë të nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu, AK ka pasur parasysh edhe nenin 1 të LPP-së pasi që fondet publike duhet të përdoren në mënyrë më ekonomike dhe në mënyrë transparente.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK VUSHTRRI";
- 1x1 OE "Milaim Bejta B.I Bushgegu89"-Prishtinë;
- 1x1 OE "N.T.P "AGONITI"-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.